



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
BASHKIA GRAMSH  
KËSHILLI BASHKIAK

PROÇESVERBAL

Mbledhje jashte radhe e Këshillit Bashkiak Muaji QERSHOR mbajtur sot me datë  
07/06/2024 ora 10:00 në sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak.

Në mbledhje marrin pjesë 14 këshilltarë: Enis Zani, Albert Ceci, Brunilda Gjevori, Arnilda Dakare, Dalip Hazizaj, Fatbardh Cekrezi, Visarion Bici, Edmond Guri, Erald Carciu, Ardiana Hasa, Ramazan Braho, Kujtim Brahimi, Alfrida Shahini.

Mbledhja drejtohet nga Kryetari i Këshillit z. Enis Zani.

Në zbatim të Nenit 192 të rregullores së Këshillit Bashkiak; "Kryetari i Bashkisë ka të drejtë të ftojë stafin e tij në mbledhjet e Këshillit, për të dhënë shpjegime juridike dhe ligjore për projekt vendimet e paraqitura nga ekzekutivi në mbledhjen e Këshillit"; asistuan në mbledhje disa prej drejtorëve dhe përgjegjësit e drejtorive përkatëse që dorëzuan projekt vendimet dhe relacionet, merr pjesë Kryetari i Bashkisë, B. Ajazi.

E. Zani: Pershendetje, sipas njoftimit sot kemi 2 pika në rend dite, një prej të cilave do e fusim sot rishtazi:

- 1- "Mbi domosdoshmerine e vendosjes së tarifave të shërbimit të kanalizimeve të ujërave të ndotura në pjesën Ujesjeslles Kanalizime Gramsh",
- 2- Për një ndryshim në vendimin nr 77 datë 30.11.2023 « Për trajtimin ekonomik të nxenesve të arsimit parauniversitar në institucionet arsimore profesionale për vitin shkollor 2023-2024 jeni dakort të miratohet rendi i ditës, edhe pika 2?

\*Miratohet rendi i ditës me 14 Vota PRO

Sekretar i Këshillit  
Xhulia Gjini



## Çështja 1

### 1- Mbi domosdoshmerine e vendosjes se tarifave te sherbimit te kanalizimeve te ujrave te ndotura njesine Ujesjeslles Kanalizime Gramsh

Në mbledhje marrin pjesë 14 këshilltarë: Enis Zani, Albert Ceci, Brunilda Gjevori, Arnilda Dakare, Dalip Hazizaj, Fatbardh Cekrezi, Visarion Bici, Edmond Guri, Erald Carciu, Ardiana Hasa, Ramazan Braho, Kujtim Brahimi, Alfrida Shahini.

**E.Zani:** Ky material është shtyre disa here, jemi edhe jashtë afatit ligjor, është një shërbim që e kryen bashkia dhe nuk e ka në kompetencë.

**K.Bashkise:** Në Maj të 2024 (në mos gaboj dt.22), Këshilli i Ministrave ka marrë një vendim për kalimin e Ujesjeslles Kanalizime nga pushteti vendor në drejtorinë rajonale, prej disa kohësh qëndron një material lidhur me tarifën, ligjerisht kompetencën e ka drejtoria rajonale Elbasan. Na është propozuar tarifa me e ulët, është një detyrim ligjor dhe nuk mund të bëhemi në pengesë. Punonjësit po i paguan bashkia prej 1 viti i gjysmë. Në të gjithë qarkun është tarifimi me e ulët. Këshilli i parë e ka bërë hapin e parë të kalimit të aseteve, vendimarrja dhe kompetenca është totalisht e juaja për këtë propozim. Unë personalisht jam i mendimit që duhet të bëjmë një rishikim të këtyre tarifave.

**E.Zani:** Ka pyetje?

**K.Cala:** Sa rëndon kjo të qytetarët? Impakti? Fatura re qytetarit sipas llogarise time rritet me 250 leke në muaj, nuk është pak shumë për qytetarët tane. Edhe pagesat që kemi bërë për punonjësit nuk duhej të bënit.

**E.Zani:** Nuk kemi të bëjmë me rritje tarifash në këtë rast, kemi të bëjmë me transferim në drejtorinë rajonale. Transferimi i aseteve bëhet me vendim këshilli. Ndryshimi është që tarifën që aktualisht paguhen do të paguhen në vazhdim drejtorisë rajonale që ligjerisht do të kryejë shërbimin.

**F.Cekrezi:** Fatmiresisht në kemi uji me rrjedhje të lirë, duhet të bëhet një konsultim i gjërë publik, sa i përket kalimit të kësaj pike nuk duhet të zvarisim si detyrim ligjor që kemi.

**E.Carciu:** Vazhdoj të theksoj rëndësinë e transmetimit online të mbledhjeve. Është diskutuar buxheti që ka qenë i konsiderueshëm dhe del që nuk paska mundësi të paguhen punëtorët, pra nuk është mirë menaxhuar.

**K.Bashkise:** Jo, unë e kam menaxhuar shumë mirë por nuk e kam detyrim ligjor.

**E.Carciu:** Në duam garanci që kur të këto probleme të gjejnë zgjidhje qytetarët, lidhur me transferimin jam dakort.

**E.Guri:** Vendimi i mëparshëm i këshillit a është i bazuar në nenin 23 dhe 54 të ligjit 139/2015?

**E.Zani:** Pyetje tjetër?

**F.Cekrezi:** Duke qenë se në nenin 23 (citon nenin) në kemi transferuar një të drejtë që ligji na i ka kërkuar, kemi lidhur edhe një kontratë sipas kodit civil.

**E.Zani:** Keni pyetje, kalojmë në votim?

**\*Miratohet pika e 1 e rendit të ditës me 12 Vota PRO**

**\*Votuan KUNDER : E.Carciu**

**\*Votuan ABSTENIM: K.Cala**

**Sekretar i Këshillit**

**Xhulia Gjini**



**Kryetar i Këshillit**

**Enis Zani**

## Çështja 2

### 2-Për dhënien e ndihmës financiare znj.Thëllënxë Llalla.

Në mbledhje marrin pjesë 14 këshilltarë: Enis Zani, Albert Ceci, Brunilda Gjevori, Arnilda Dakare, Dalip Hazizaj, Fatbardh Cekrezi, Visarion Bici, Edmond Guri, Erald Carciu, Ardiana Hasa, Ramazan Braho, Kujtim Brahimi, Alfrida Shahini.

**E.Zani:** Lidhur me kete material, propozohet vetem ndryshim dhe saktësim ne vendim , pasi eshte bere nje lapsus ne te dhenat e nje nxenesi, konkretisht ne mbiemer. Nga Carciu i eshte bere Qyra, duhet qe te rregullohet ne menyre qe te mos i digjet bursa. Jeni dakort?

**\*Miratohet pika e 2 e rendit të ditës me 14 Vota PRO**



Sekretar i Këshillit  
Xhulia Gjini

Kryetar i Këshillit  
Enis Zani



REPUBLIKA E SHQIPERISË  
BASHKIA GRAMSH  
KESHILLI BASHKIAK

Gramsh, më 07/06/2024



**LISTË PREZENCË E KËSHILLTARËVE BASHKIAK**

Mbledhje Jashte Rradhe e Këshillit Bashkiak Muaji QERSHOR 2024

EMER MBIEMER	07 QERSHOR 2024	EMER MBIEMER	FIRMA
1- KODHEL ÇALA			
2- VALBONA VERUSHI			
3- LULJETA DOLLANI			
4- ENIS ZANI	Emis 07.06.2024	Enis Zani	
5- GRETA LENA			
6- VISARION BICI	✓	Visarion Bici	
7- ARDIANA HASA	07.06.2024	Ardiana Hasa	
8- ALBERT CECI	✓	ALBERT CECI	
9- RAMAZAN BRAHO		Ramazan Braho	
10- EDMOND GURI	07.06.2024	Edmond Guri	
11- ERALED ÇARÇIU	07.06.2024	Erald Çarçiu	
12- IDRI KOKLA			
13- ERISA ZOGU			
14- KUJTIM BRAHIMI	-	Kujtim Brahim	
15- MARSELA IBRO			
16- ALFRIDA SHAHINI	✓	Alfrida Shahini	
17- DALIP HAZIJAJ	07.06.2024	Dalip Hazijaj	
18- ARNILDA DAKARE	07.06.2024	Arnilda Dakare	
19-BRUNILDA BALLOLLI			
20-FATBARDH ÇEKREZI	07.06.2024	Fatbardh Çekrezi	
21-BRUNILDA GJEVORI	Brunilda Gjevori	07.06.2024	

SEKRETARI I KËSHILLIT  
XHULIA GJINI

*[Handwritten signature]*